

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Z. Leke Gjoni

Adresa: Lagjia Lisen, Qyteti Vau Dejes, se oferta e paraqitur, për Lotin I, Ekonomia Pyjore Gomsiqe, Për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme me një vlerë të përgjithshme prej 43470(dyzet e tre mije e katërqind e shtatëdhjete) lek pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Z. Tomë Prenga

Adresa: Lagjia Kinoklub, Qyteti Vau Dejes, se oferta e paraqitur, për Lotin II, Ekonomia Pyjore Gjadër Mnele, Për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme me një vlerë të përgjithshme prej 8625 (tetë mije e gjashtëqind e njëzet e pesë) lek pa TVSH. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Vau Dejes*, me Adrese Rruga Qafa e Gurit Vau Dejës dhe reference kontakti zyrën e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit ,kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.10.2018.

S'ka ankesa.

BASHKIA KRUJË **NJOFTIM PËR BOTIM**

Për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste-Kruje në ngastrat pyjore me nr. 30/b ,39/a , 43/a, 44/a, 45/a, 46/a, 48/a, 50/a, 52/a, 53/a, 55/a, 56 ,57, 58/a, 59/a, 64/a, 65/a, 68/b, 72/a, dhe te ekonomise pyjore “ Bura – Mukje “ ne ngastrat me nr.6/a , 7/a , 8/a , 9/a , 14/a , 15/a , 18/a , 21 , 22 , 23 , 24 , 25/a , 26 , 27 per vjeljen e 149 ton degëza (gjethe) të mersinës,ne siperfaqen prej 158.3 ha ne ekonomine pyjore Kraste – Kruje dhe 116.4 ha ne ekonomine pyjore Bura - Mukje , pronë e bashkisë Krujë me afat perdorimi 1 vjeçar.

1. Fillimi i procedurave **Për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste-Kruje në ngastrat pyjore me nr. 30/b ,39/a , 43/a, 44/a, 45/a, 46/a, 48/a, 50/a, 52/a, 53/a, 55/a, 56 ,57, 58/a, 59/a, 64/a, 65/a, 68/b, 72/a, dhe te ekonomise pyjore “ Bura – Mukje “ ne ngastrat me nr.6/a , 7/a , 8/a , 9/a , 14/a , 15/a , 18/a , 21 , 22 , 23 , 24 , 25/a , 26 , 27 per vjeljen e 149 ton degëza (gjethe) të mersinës,ne siperfaqen prej 274.7 ha, pronë e Bashkisë Krujë me afat perdorimi 1 vjeçar.**
2. Qellimi i perdorimit është dhënia në perdorim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore të përcaktuar në pikën 1, për prodhimin e degëzave (gjetheve) të mersinës, sipas ligjeve në fuqi.

3. Çmimi dysHEME i fillimit të konkurrimit është 223245 (dyqind e njezet e tre mijë e dyqind e dyzet e pese) lekë, e përlogaritur kjo sipas VKM-se nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.10.2010, lidhja 5 “Tarifat dysHEME për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta”
4. Afati i dhënies me qira do të jetë 1 vit.
5. Pikët vlerësuese do të jenë :
- projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin Fletorja Zyrtare PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit **30 pikë**
 - planin e rehabilitimit të sipërfaqes **25 pikë**
 - masën e qirasë për kv /lek/vit **45 pikë**
6. Terheqja e dokumentacionit te nevojshem do te behet ne zyren e caktuar nga bashkia per pyjet dhe kullotat.
7. Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për marrjen me qira do të jetë si më poshtë:
- kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet.
 - ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
 - projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar.
 - planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.
 - çmimin e qirasë së ofruar për kv/lek/vit;
 - adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.
 - vertetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor që nuk është në proces gjyqësor që lidhet me aktivitetin.
 - vertetim nga Prokuroria e rrethit gjyqësor që nuk është në ndjekje penale
 - licencë QKL e noterizuar
 - çertifikatë regjistrimi (NIPT) e noterizuar
 - deklarimin e kerkuesit që ka stafin dhe të gjitha poajisjet për veprimtarinë që do të ushtroje.
 - garanci bankare.
8. Do te kihet parasysh zbatimi i VKM nr 438 , date 08.06.2016 “ Per Kriteret dhe rregullat e shfrytezimit te pyjeve dhe te shitjes se materialit drusor e te prodhimeve tjera pyjore e jo pyjore ”, pika 33, 34, 35 ,.
- Pika 17. Ne pyjet me shkurre te cilat ripertrihen me llastare , prerja lejohet nga 1 tetori deri me 31 mars te vitit pasardhes
9. Paraqitja e dokumentacionit do te kryhet prane Bashkise Krujë,Zyra e Njësise së Prokurimeve, me datë 09.11.2018, ora 11-00.